



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA  
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 144 Dt. 08.03.2023  
PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

Në bazë të Rregullores Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), si dhe në bazë të Vendimit Nr 13/2023 të Komisionit të Garave, Komisioni Disiplinor i FBK-së, me datë 08.03.2023 merr këtë:

## VENDIM

- I. Shpallet e PRANUESHME kërkesa e Komisionit të Garave të FBK-së e datës 01.03.2023.
- II. SHQIPTOHET dënim me ndalesë për kryerje të detyrës për periudhë kohore prej 18 muaj për z. Endrit Basha.

## ARSYETIM

Me datë 01.03.2023, në bazë të Vendimit nr.13/2023 të Komisionit të Garave të FBK-së, Komisioni Disiplinor (KD), përmes postës elektronike nga Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, ka pranuar kërkesën për inicim të procedurës disiplinore ndaj z. Endrit Basha, në lidhje me incidentin nga ndeshja mes KBF Peja 03 dhe WBC Bashkimi, xhironja IX e Ligës së Parë Femrat (edicioni 2022/23).

Në bazë të Raportit të ndeshjes supozohet se, Endrit Basha, i cili në momentin e incidentit veçse ka qenë duke shërbyer dënim të shqiptuar paraprakisht, pas përfundimit të ndeshjes kërcen nga pjesa e shikuesëve dhe tenton t'i sulmojë zyrtarët e ndeshjes, gjegjësisht gjyqtarët dhe vëzhguesin e ndeshjes. Poashtu, Raporti shton se gjatë tërë kohës së zhvillimit të ndeshjes, po i njëjti vazhdimisht ka kërcënuar dhe ofenduar gjyqtarët.

Në këtë kuadër, KD ka mbajtur takim më 08.03.2023. Në takim kanë qenë prezent anëtarët e KD: Omer Daku (Kryetar), Armend Hamiti (Anëtar), Blerim Vuniqi (Anëtar), si dhe në përputhshmëri me nenin 37 të Rregullores Disiplinore, u.d. Sekretari i Përgjithshëm i FBK-së dhe Këshilltarja Ligjore për Sport e FBK-së.

Komisioni Disiplinor ka pasur në dispozicion Raportin e ndeshjes mes KBF Peja 03 dhe WBC Bashkimi dhe inçizimin nga përfundimi i ndeshjes.

Gjatë trajtimit të incidentit, u shqyrtuan provat dhe dokumentet në dispozicion, dhe u konstatua si në dispozitiv, për arsyet në vijim.

## Kosovo Basketball Federation

Supported by:



TEB

General Sponsor:

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball supporters:



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

## 1. Kompetenca e KD për të shqyrtuar rastin

Komisioni i Garave të FBK-së, bazuar në Raportin e ndeshjes, ka publikuar Vendimin nr.13/2023. Ky i fundit arsyeton se, si shkelës potencial recidivist, rast i z. Endrit Basha i takon Komisionit Disiplinor për trajtim.

Duke u thirrë në nenin 4 dhe 33 të Rregullores Disiplinore, është kërkuar inicimi i procedurës disiplinore, dhe rrejdhimisht, Komisioni Disiplinor ka kompetencë të shqyrtojë kërkesën nga Komisioni i Garave të FBK-së.

## 2. Meritat e Vendimit

Pas shqyrtimit të Raportit të ndeshjes mes KBF Peja 03 dhe WBC Bashkimi, inçizimit nga përfundimi i ndeshjes në fjalë, dhe duke marrë parasysh se z. Endrit Basha tashmë mban dënim mandatar të mëhershëm nga organet e FBK-së, Komisioni Disiplinor ka vlerësuar sipas bindjes së lirë në bazë të provave të lartpërmendura.

Në bazë të Informatorit Nr 3 Kupa Liga e Parë Femrat 2022, z. Endrit Basha (KBF Pjea 03), konform nenit 34 dhe 57 të Rregullores Disiplinore të FBK-së, i'u shqiptua dënim me ndalesë kohore për kryerje të detyrës për 1 vit nga dita e publikimit të Informatorit, gjegjësisht prej datës 05.04.2022.

Në bazë të nenit 55 të Rregullores Disiplinore të FBK-së, kush vepron direkt apo indirekt kundër vendimeve të organeve të organizatës së basketbollit ose në mënyrë tjetër rrezikon autoritetin dhe efikasitetin e atyre organeve, do të dënohet me dënim kohor të ndalesës për lojë apo të kryerjes së detyrës. Bazuar në Raportin e ndeshjes dhe inçizimin, z. Basha shihet duke cenuar fushën në mënyrë agresive dhe rrjedhimisht duke vepruar direkt kundër vendimit të datës 05.04.2022. Për më shumë, sipas Nenit 24, në rast se kryerësi është përsëritës, kjo do konsiderohet si rrethanë rënduese.

## Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball supporters:



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

Në përputhje me nenet paraprake, Komisioni Disiplinor shqipton dënim me ndalesë për kryerje të detyrës ndaj z. Endrit Basha për periudhë kohore prej 18 muajsh.

**Vërejtje:** në përputhshmëri me nenin 20, paragrafi 5 i Rregullores Disiplinore, në rast se kryerësi pas dënimit të dytë kryen kundërvajtje të re, mund ti shqiptohet dënimi i ndalesës së përjetshme për loje ose kryerje të detyrës.

Ky vendim hyn në fuqi më 05.04.2023, pas kryerjës së dënimit të mëhershëm.

**KOMISIONI DISIPLINOR :**

Armend Hamiti  
Anëtar

Omer Daku  
Kryetar

Blerim Vuniqi  
Anëtar

Vendimi i dërgohet:

- z. Endrit Basha (KBF Peja 03)
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor të FBK-së
- Komisionit të Garave
- Arkivit të FBK-së



**Kosovo Basketball Federation**

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

